

ORIENTIMI PËR KARRIERËN NË SHQIPËRI në mbështetje të qëllimeve më të gjera në lidhje me aspekte që kanë të bëjnë me ekonominë, punësimin, shoqërinë, rininë, arsimin dhe formimin

Orientimi për karrierën zakonisht përkufizohet si shërbimi që i ndihmon individët për të bërë zgjedhjen e tyre sa i takon arsimin, formimit dhe profesionit dhe për të menaxhuar karrierën e tyre. Këshillimi dhe orientimi për karrierën parashikohet në Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) dhe në Ligjin për Nxitjen e Punësimit, të cilët janë hartuar me kontributin e të gjithë aktorëve kryesorë.

Kapaciteti institucional

Reforma në sistemin e AFP-së në Shqipëri është përqendruar kryesisht në përmirësimin e atraktivitetit, qasjes, lidhjes dhe relevancës së tij me tregun e punës. Gjithashtu, reforma përpiqet të garantojë parimet thelbësore të gjithëpërfshirjes, autonomisë, cilësisë, bashkëpunimit, pjesëmarrjes, lëvizshmërisë dhe diversitetit. Në vitin 2019, politikat për zhvillimin e aftësive dhe kornizat ligjore dhe institucionale që rregullojnë sektorin u përmirësuan ndjeshëm. Miratimi i ligjit nr. 15/2019 për Nxitjen e Punësimit në muajin mars të vitit 2019 plotësoi kornizën ligjore në lidhje me politikat dhe programet e punësimit dhe zhvillimin e aftësive. Më e rëndësishmja, ajo hapi rrugën për finalizimin e akteve nënligjore të ligjit të AFP-së.

Përveç kësaj, ky ligj parashikoi kalimin e ofruesve të arsimit dhe formimit profesional nën përgjegjësinë dhe menaxhimin e Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA) me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) 554/2019. Struktura e miratuar për AKPA-n përfshin rritjen e konsiderueshme të burimeve njerëzore në nivel qendror në mënyrë që institucioni të mund të kryejë të gjitha funksionet e parashikuara nga ligji nr. 15/2017 për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë. Misioni i agjencisë është të zhvillojë dhe mbështesë fuqinë punëtore shqiptare përmes ofrimit të arsimit profesional, kualifikimit, orientimit profesional dhe shërbimeve të punësimit.

Ristrukturimi i Agjencisë Kombëtare të AFP-së dhe Kualifikimeve (AKAFPK), përfshirë të gjitha funksionet e reja të parashikuara nga Ligji për AFP-në dhe Ligji për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, plotëson kryesisht kornizën institucionale që rregullon sektorin e AFP-së. AKAFPK është përgjegjëse për zhvillimin e sistemit të kualifikimeve profesionale bazuar në nevojat e tregut të punës dhe në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Kjo agjenci është përgjegjëse edhe për zhvillimin e Listës Kombëtare të Profesioneve bazuar në Klasifikimin Standard Ndërkombëtar të Profesioneve (ISCO) 2008. Ajo kryen vlerësimin e nevojave të tregut për kualifikime; zhvillon standardet e profesionit dhe kualifikimit,

PËRGJEGJËSITË

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MEF) zhvillon politika në fushën e punësimit dhe arsimit dhe formimit profesional, dhe koordinon bashkëpunimin me institucionet e tjera qendrore që janë përgjegjëse për aspekte specifike të orientimit për karrierën.

Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA) është, në aspektin administrativ, përgjegjëse për AFP-në dhe ofron shërbime në lidhje me orientimin profesional dhe punësimin.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) është autoriteti më i lartë ekzekutiv që menaxhon arsimin parauniversitar në Shqipëri. Ministria zhvillon politika për sistemin arsimor parauniversitar dhe miraton programe të bazuara në kompetencat kyçe për të nxënësit gjatë gjithë jetës, të cilat përfshijnë çështje që kanë të bëjnë me orientimin për karrierën të ofruara përmes një moduli me zgjedhje.

Aktualisht, në Shqipëri ekzistojnë 61 bashki dhe 373 njësi të qeverisjes vendore, nga të cilat Bashkia e Tiranës është mbështetur nga donatorët (projekti RisiAlbania) për të prezantuar orientimin për karrierën si një shërbim në nivel bashkiak që synon kryesisht të rinjtë jo-universitarë dhe që mbulon arsimin parauniversitar.

Institucionet e arsimit të detyrueshëm kanë zhvilluar module të ndryshme në lidhje me orientimin për karrierën, të cilat janë gati për t'u lëvruar nga mësuesit kujdestarë në bashkëpunim me psikologët e shkollës.

kurrikulën kombëtare (për kurse trajnimi afatgjata dhe afatshkurtra, materiale mësimore, instrumente vlerësimi, etj.) dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit mësimdhënës në sistemin e AFP-së; harton mekanizmin për përfshirjen e kualifikimeve gjatë gjithë jetës në nivelet e KSHK-së; akrediton ofruesit e AFP-së dhe qendrat e vlerësimit për njohjen e të nxëniet të mëparshëm për nivelet 2-5 të KSHK-së; koordinon veprimtarinë e komiteteve sektoriale; dhe monitoron dhe mbështet ofruesit e AFP-së për zbatimin e procesit të vetëvlerësimit.

Në bashkëpunim me sektorin e biznesit, AKAFPK ka përgatitur Listën e rishikuar Kombëtare të Profesioneve, e cila është miratuar me VKM-në Nr. 154, datë 20 shtator 2017 dhe është botuar në faqen e internetit të agjencisë (<http://www.akaftp.gov.al/lista-kombetare-e-profesioneve/lista-e-profesioneve/>). Në kuadrin e objektivit strategjik për 'forcimin e lidhjeve midis të nxëniet dhe punës dhe lehtësimin e kalimit në punë', Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022 (vendimi nr. 659, datë 10 tetor 2019) ka parashikuar krijimin e sistemit për orientimin në karrierë. Strategjia parashikon zbatimin e funksioneve të këshillimit për karrierën brenda njësive të zhvillimit; ngritjen e kapaciteteve të njësive të zhvillimit për këshillimin dhe orientimin për karrierën; krijimin e sistemit të informacionit për orientimin në karrierë; dhe vënien në dispozicion të informacionit të përditësuar në lidhje me karrierën për nxënësit dhe kursantët e AFP-së. Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MEF), ofruesit e AFP-së (njësitë e zhvillimit) dhe AKPA janë përgjegjës për arritjen e këtij objekti specifik. Mbi bazën e ndryshimeve më të fundit ligjore dhe objektivave të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2020, individët kanë qasje të shërbimit të orientimit dhe këshillimit në faza të ndryshme të jetës së tyre - qofshin ata në arsim ose kualifikim, të punësuar apo të papunë.

Institucionet kanë përgjegjësi ligjore për të ofruar shërbime orientimi nëpër shkolla. Në mbështetje të nenit 23 të ligjit nr. 15/2017 për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë, sistemi i AFP-së ofron shërbime të tilla si orientimi për karrierën për nxënësit dhe kursantët e saj, dhe këshillimin dhe orientimin për të lehtësuar punësimin e tyre, bazuar në rregullat e përcaktuara nga ministria përgjegjëse për sistemin e AFP-së. Këto shërbime ofrohen nga njësia e zhvillimit pranë ofruesit të AFP-së. Në mbështetje të nenit 15 të ligjit, pranë çdo ofruesi të AFP-së është ngritur njësia e zhvillimit, e cila ka funksione të ndryshme (neni 15, pika 2) përfshirë ofrimin e shërbimit të orientimit për karrierën për nxënësit dhe kursantët. Funksionet e tjera përfshijnë: zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve brenda institucioneve, zhvillimin e programeve mësimore në nivel ofruesi, vendosjen e lidhjeve ndërmjet ofruesve dhe biznesit, orientimin në karrierë për nxënësit dhe kursantët, hartimin dhe zbatimin e projekteve të zhvillimit, realizimin e marketimit të ofruesit dhe mbledhjen e të dhënave të gjurmimit në nivel ofruesi.

Neni 37 (i udhëzimit nr. 11, datë 3 mars 2020, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional") përcakton përbërjen e njësive të zhvillimit të ofruesve të AFP-së: personeli mësimor në shkollat profesionale (numri i orëve totale javore të alokuara për njësinë e zhvillimit llogaritet bazuar në numrin e nxënësve dhe numrin e programeve të ofruara) ose anëtarët e tjerë me funksione që nuk lidhen drejtpërdrejt me mësimdhënien. Në qendrat e formimit profesional, njësia e zhvillimit është pjesë e fushës së administrimit.

PËRGJEGJËSITË

Institucionet e arsimit të mesëm të përgjithshëm ofrojnë edhe module me zgjedhje përveç kurrikulës bazë (konkretisht module profesionale dhe lëndore me zgjedhje).

Njësitë e zhvillimit janë ngritur dhe veprojnë në të gjitha institucionet e arsimit profesional dhe arsimit për të rritur. Për t'i shërbyer koordinatorëve të këshillimit dhe orientimit për karrierën në punën e tyre të përditshme është vënë në dispozicion edhe një manual.

Zyrat përgjegjëse për shërbimet e karrierës dhe për mbështetjen e ish-studentëve në çdo institucion të arsimit të lartë lehtësojnë lidhjen midis karrierës akademike dhe mundësive të punësimit për studentët e diplomuar. Fakulteti i Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës ofron një program të nivelit master për këshilluesit e karrierës.

Zyrat e Shërbimit Publik të Punësimit ofrojnë informacion dhe orientim në lidhje me të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zgjedhjen e karrierës dhe zhvillimin e karrierës, llojet e kurseve të trajnimit ose studimit, ndryshimin dhe lëvizshmërinë profesionale, kualifikimin dhe rikualifikimin e mëtejshëm, sistemimin në punë dhe vetëpunësimin.

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë në rajone të ndryshme, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe me bashkitë, organizojnë panairë të përvitshme të punës dhe studimit. Aktivitetet e këshillimit në karrierë zhvillohen gjatë këtyre aktiviteteve.

Sistemi i informacionit për tregun e punës është një pikë shumë e ndjeshme, që nga mbledhja e informacionit deri tek vënia në dispozicion e këtij informacioni për publikun. Informacioni për tregun e punës është i fragmentuar. Ofrimi i informacionit në mënyrë të strukturuar kërkon shumë punë. Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) ka kryer një studim të sistemit të informacionit për tregun e punës (SITP). Rezultatet e studimit do të përdoren për të riprojektuar SITP-në, i cili së bashku me portalin e punësimit (investuar nga shteti shqiptar) do të finalizohen në vitin 2020. Ndryshimet strukturore (si pasojë e ndryshimeve më të fundit ligjore) kanë bërë të nevojshme riprojektimin e plotë të sistemit aktual të informacionit për shërbimet e punësimit. AKPA po bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për një sistem unik të shërbimeve të punësimit, integrimin e bazës së të dhënave me bazat e tjera të të dhënave në nivel kombëtar dhe për riorganizimin e portalit të aplikimeve në internet.

Orientimi për karrierën nuk është adresuar asnjëherë në mënyrë sistematike, edhe pse ka qenë gjithmonë në krye të rendit të ditës dhe prioritet i institucioneve të interesuara. Megjithatë, në vend vihet re ekzistenca e një niveli të mirë bashkëpunimi midis kontribuesve kryesorë në fushën e orientimit për karrierën (si për shembull, marrëveshja midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe bashkisë së Tiranës për ngritjen e një qendre karriere në nivel qyteti), rritja e ndjeshmërisë ndaj orientimit për karrierën dhe gatishmëria për të bashkuar bazat e të dhënave dhe burimet e informacionit për individët (edhe pse në disa raste po përdoret një qasje nga poshtë-lart). Ndryshimet më të fundit ligjore (Ligji për AFP-në, Ligji për Nxitjen e Punësimit dhe Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022) dëshmojnë qartë gatishmërinë, mbështetjen politike dhe kulturën në ndryshim drejt orientimit për karrierën.

Kapaciteti organizativ

Institucionet e arsimit të detyrueshëm: Gjatë viteve të fundit, i gjithë sistemi arsimor i është nënshtruar zbatimit të një sërë reformave. Kjo e ka vënë sistemin në sprovë duke i kërkuar të ndryshojë në mënyrë të vazhdueshme. Në arsimin parauniversitar, Shqipëria ka miratuar një kurrikulë të re të bazuar në kompetenca. Modulet për orientimin në karrierë janë përdorur vetëm në mënyrë sporadike në formën e aktiviteteve jashtëshkollore, pa vlerësuar nëse modulet i shërbejnë qëllimit të tyre apo jo. Sidoqoftë, më shumë sesa arsimi tradicional, arsimi i bazuar në kompetenca mbështet zhvillimin e aftësive dhe qëndrimeve përkatëse të transferueshme për të fituar përshtatshmëri në karrierë.

Shkollat e mesme: Ideja që shkollat të fillojnë të krijojnë një qëndrim pozitiv ndaj vetë-punësimit, frymës së iniciativës dhe sipërmarrjes është pjesë e të gjitha programeve mësimore për arsimin e mesëm të përgjithshëm. Orientimi për karrierën në arsimin e shkollës së mesme ofrohet përmes një moduli jo të detyrueshëm ose me zgjedhje të quajtur 'edukim për karrierën' që përbëhet nga 36 orë mësimore për t'i pajisur nxënësit me aftësinë për të identifikuar qëllimet e karrierës, për të zhvilluar aftësi kërkimore në lidhje me karrierën, për të planifikuar arsimimin ose kualifikimin ose punësimin e mëtejshëm, dhe për të realizuar procedurat e kërkimit në lidhje me karrierën. Përveç kësaj, moduli ofron informacion edhe në lidhje me profesione të caktuara dhe shërben si një lloj orientimi në karrierë për personat që nuk arrijnë të shkojnë në universitet. Përveç kurrikulës kryesore, shkollat e mesme të përgjithshme ofrojnë edhe module me zgjedhje, konkretisht module profesionale me zgjedhje (për montimin e pajisjeve shtëpiake, riparime mekanike, etikën e veshjes dhe dekorimit, guidën turistike, kopshtarinë, asistentët zyre, etj.) dhe module lëndore me zgjedhje (edukimi për karrierën siç u përmend më lart, kultura financiare, prona intelektuale, trashëgimia kulturore, etj.).

Institucionet e arsimit profesional dhe arsimit për të rritur: Njësia e zhvillimit, e cila është pjesë e strukturës së brendshme të secilit institucion të AFP-së, ofron shërbimet e orientimit në karrierë për nxënësit dhe kursantët. Sistemi i AFP-së ofron shërbime për nxënësit dhe kursantët në lidhje me

KULTURA NË LIDHJE ME ORIENTIMIN PËR KARRIERËN

Mendësia mbizotëruese në lidhje me orientimin për karrierën në nivel organizativ është përputhja e nevojave të hapura për aftësi me burimet njerëzore të kualifikuara duke përshtatur ofertën e aftësive me nevojat e ndërmarrjeve në treg.

Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA) nuk e konsideron orientimin dhe këshillimin për karrierën nga perspektiva e politikave ekonomike. Në vend të kësaj, qasja ka të bëjë me ofrimin e ndihmës dhe orientimin në karrierë për të rriturit drejt profesioneve që i përshtaten nivelit ose tërësisë së aftësive të tyre ose orientimin drejt rehabilitimit në zona më të përshtatshme.

Kërkesa e AKPA-s për të shtrirë projektin e GIZ Start SMART në nivel mbarrëkombëtar është një shenjë e ndërgjegjësimit në lidhje me rëndësinë e orientimit për karrierën dhe mbështetjes politike për të.

Kultura e vazhdimet të studimeve në arsimin e lartë është mbizotëruese, dhe shkollat e mesme ofrojnë orientimin në karrierë për ata persona që nuk arrijnë të shkojnë në universitet.

udhëzimin, këshillimin dhe orientimin për karrierën për të lehtësuar punësimin e tyre. Numri total i orëve javore të angazhimit të anëtarëve të njësisë së zhvillimit varet nga numri i nxënësve dhe ndihma që ofrohet. Edukimi për karrierën ose orientimi profesional është pjesë integrale e kurrikulës shkollore, e cila shpesh plotësohet me aktivitete jashtëshkollore, shpesh në bashkëpunim me kompani të ndryshme (vizita në biznese, panairë pune dhe praktika profesionale). Qëllimi është përgatitja e nxënësve për botën e punës duke përmirësuar aftësitë e tyre për menaxhimin e karrierës, për të kërkuar dhe përdorur informacionin në dispozicion dhe për të marrë vendime.

Institucionet e arsimit të lartë e kanë kuptuar rolin e rëndësishëm të qendrave të karrierës për ofrimin e shërbimeve të orientimit në karrierë për studentët dhe kanë ndërmarrë hapa për ngritjen e tyre. Shumica e universiteteve kanë caktuar staf me kohë të plotë për të menaxhuar qendrat e tyre të karrierës dhe kanë vënë në dispozicion një zyrë brenda institucioneve. Ky veprim ndoshta është ndërmarrë për shkak të detyrimeve që duhet të përmbushin në lidhje me akreditimin dhe për shkak të ndërgjegjësimit në rritje për rëndësinë e shërbimeve për orientimin e studentëve në lidhje me tregun e punës dhe zhvillimin akademik dhe profesional. Zyrat për ofrimin e shërbimeve të karrierës dhe për mbështetjen e ish studentëve synojnë të forcojnë lidhjen midis kualifikimit akademik dhe mundësive të punësimit të studentëve të diplomuar dhe të inkurajojnë studentët për të marrë pjesë në aktivitete jashtëshkollore të një natyre shkencore, profesionale, sociale dhe kulturore. Plani i punës i kësaj zyre përfshin shkëmbimin e ideve me studentë të diplomuar, diskutime mbi tema aktuale, organizimin e aktiviteteve në formë konkursi, organizimin e turneve, pjesëmarrjen në konferenca shkencore dhe fushatat humanitare dhe ndërgjegjëse. Zyra e koordinimit dhe mbështetjes së studentëve orienton, inkurajon dhe mbështet studentët për rritjen e tyre personale dhe profesionale përmes pjesëmarrjes në programe jashtëshkollore të një natyre shkencore, profesionale, sociale dhe kulturore, në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Objektivi kryesor i kësaj zyre është të ndihmojë studentët për tu përgatitur më mirë për botën e punës dhe të nxisë zhvillimin e karrierës së tyre në fusha të caktuara të studimit.

Bashkitë kanë një rol dhe funksion jo të drejtpërdrejtë në arsimin dhe formimin profesional dhe në punësim, përmes mandatit të tyre për të punuar për zhvillimin ekonomik në nivel vendor. Në këtë këndvështrim, bashkitë luajnë rolin e partnerit dhe bashkëpunëtorit për institucionet e AFP-së dhe zyrat e punësimit. Bashkitë, në cilësinë e tyre si ofruese të shërbimeve sociale vendore, mund të luajnë një rol të rëndësishëm edhe për koordinimin e pjesëmarrësve në programet e nxitjes së punësimit të AKPA-s. Qendra e karrierës në nivel qyteti (në Tiranë) do të fillojë aktivitetin e saj në muajin nëntor të vitit 2020. Qendra do të jetë e hapur për të gjithë, përfshirë studentët në moshë të re si dhe të rriturit. Stafi i qendrës është zgjedhur dhe trajnuar dhe është i gatshëm për të filluar punën.

Zyrat e Shërbimit Publik të Punësimit ofrojnë shërbime për sistemimin në punë të klientëve si dhe shërbime të orientimit për karrierën. Ato ofrojnë informacione dhe udhëzime në lidhje me të gjitha fushat e zgjedhjes së karrierës dhe zhvillimit të karrierës, llojet e kursit të trajnimit ose të studimit, ndryshimin dhe lëvizshmërinë profesionale, kualifikimin dhe rikualifikimin e mëtejshëm, sistemimin në punë dhe vetëpunësimin, dhe të gjitha çështjet e lidhura me tregun e punës duke përfshirë skemat e tregut të punës dhe ndihmën financiare. Shërbimi ofrohet kryesisht nga specialistët e punësimit, puna e të cilëve bazohet në një analizë të pikave të forta dhe të dobëta (profilizimi). Ata verifikojnë aftësitë, kompetencat dhe shprehitë e nevojshme për vendet e lira të punës. Në një plan veprimi përshkruhen edhe hapat e mëtejshëm dhe përgjegjësitë e personit të papunë dhe specialistit të punësimit.

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë (DHTI) është organizatë jofitimprurëse që përfaqëson dhe mbron interesat e anëtarëve të saj dhe bashkëpunon dhe shkëmben informacione me administratën publike. Sipas ligjit, anëtarësia në DHTI është e detyrueshme për ndërmarrjet dhe personat juridikë të regjistruar në regjistrin tregtar dhe vullnetare për individët që kryejnë veprimtari tregtare. Plani i punës i DHTI-së së Tiranës për vitin 2020 përshkruan shumë aktivitete si dhe një plan për të prezantuar ide dhe njohuri në lidhje me sipërmarrjen private si një kompetencë kyçe në kurrikulën e arsimit parauniversitar dhe për të rritur praninë e bizneseve në bordet drejtuese të shkollave të mesme profesionale. Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë në Tiranë, në bashkëpunim me bashkinë e Tiranës dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, organizuan më 10-13 Shtator 2020 edicionin e 11-të të Panairit të Punës dhe Studimit. Panairi u krijua për tu ofruar mundësinë institucioneve arsimore, universiteteve dhe ofruesve të trajnimeve për të prezantuar para nxënësve/ studentëve ofertat e studimit dhe kushtet e vitit të ri akademik 2020-2021. Gjatë këtij eventi, u organizuan edhe aktivitete për këshillimin e të rinjve në lidhje me karrierën duke iu dhënë atyre mundësinë për të zgjedhur të ardhmen e tyre.

Për disa vite me rradhë, **orientimi për karrierën në Shqipëri ka qenë në fokusin e shumë projekteve të ndryshme**. Ata i kanë dhënë një shtysë orientimit për karrierën përmes kontributit të tyre në mbështetjen e kapaciteteve institucionale, organizative dhe individuale. Këto projekte i gjeni të përshkruara më poshtë.

Projekti *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ)* (2017-2020) 'Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri' (ProSEED); <https://www.giz.de/en/worldwide/43738.html>), zbatuar nga *GFA Consulting Group*, synon të rinjtë me ose pa diplomë të arsimit të përgjithshëm. Projekti i ndihmon të rinjtë të marrin kualifikime profesionale për hyrjen në tregun e punës, të rriturit në marrëdhënie pune për të ndjekur kurse trajnimi për të përmirësuar aftësitë e tyre për punësim, dhe individët e papunë dhe të nënpunësuar. Objektivi i këtij projekti është rritja e punësimit të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe të rinjve të kualifikuar të vetëpunësuar në tregun shqiptar të punës. Projekti punon për të forcuar dhe përmirësuar aftësitë për punësim dhe është i angazhuar për rritjen e niveleve aktuale të punësimit në rradhët e të diplomuarve në kurset e formimit profesional përmes aftësive dhe kualifikimeve më të mira. Në bashkëpunim të ngushtë me AKPA-n, projekti ka zhvilluar një program mësimor, module trajnimi për aftësitë e buta personale të lidhura me punën dhe aftësitë për punëkërkimin si dhe manualët për trajnerët për trajnimin *Start SMART* me qëllim plotësimin e mangësive (orientimi i pamjaftueshëm për karrierën në qendrat e formimit profesional dhe burimet e kufizuara njerëzore, veçanërisht për orientimin dhe këshillimin në karrierë në zyrat e punësimit). Modeli dhe zbatimi i trajnimit *Start SMART* në Shqipëri është tërheqës sepse kontribuon në orientimin e karrierës për punëkërkuesit e papunë. Kombinimi i trajnimit të orientuar drejt veprimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm gjatë 10 ditëve të trajnimit u ofron trajnerëve mundësinë për të marrë informacion në lidhje me aftësitë e të trajnuarve dhe për t'i drejtuar ata drejt mundësive të trajnimit, në fushat e kërkuara nga sektori privat.

Në bashkëpunim të ngushtë me AKPA-n, projekti ka zhvilluar dhe pilotuar sistemin e referimit për *Start SMART*. Qëllimi i sistemit të referimit është rregullimi i bashkëpunimit midis zyrave të punësimit dhe qendrave të formimit profesional (QFP) për zbatimin e *Start SMART*. Sistemi rregullon të gjitha procedurat përkatëse si, për shembull, regjistrimi i personave të papunë në bazën e të dhënave të AKPA-s, referimi i punëkërkuesve të papunë në QFP, regjistrimi i pjesëmarrësve për trajnimin *Start SMART* në një QFP, procesi i trajnimit në *Start SMART*, vlerësimi në fund të kursit, raportimi i QFP-ve tek zyrat e punësimit dhe hedhja e rezultateve në bazën e të dhënave të AKPA-s. AKPA i kërkoi projektit ndihmë për shtrirjen e trajnimit *Start SMART* në nivel mbarëkombëtar. Për të mbështetur këtë nismë, gjatë tremujorit të parë të vitit 2019, projekti zhvilloi aktivitetet e mëposhtme:

- trajnimi i 15 personave (TiT) për të siguruar që çdo trajner i ardhshëm për *Start SMART* të mund të trajnohet dhe certifikohet nga trajnerë shqiptarë;
- trajnimi i një grupi tjetër prej 32 trajnerësh për zhvillimin e trajnimit *Start SMART*;
- mbështetja e AKPA-s për të futur në përdorim sistemin e referimit për stafin e të gjitha zyrave shqiptare të punësimit;
- krijimi i partneriteteve midis QFP-ve të mbështetura nga projekti dhe QFP-ve që nuk janë pjesë e projektit për të siguruar që edhe QFP-të e reja do të mbështeten nga Koordinatorin Ndërlidhës me Sektorin Privat dhe një trajner *Start SMART* i QAP-ve me përvojë në zbatimin e trajnimit *Start SMART*.

RisiAlbania (<https://www.risialbania.al/>; 2013–2021), projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), po punon për të mundësuar ofrimin e shërbimeve të karrierës në shkollë përmes zyrës së bashkisë dhe një shërbimi në internet. RisiAlbania është duke përgatitur edhe një portal karriere. Projekti ka përgatitur një manual për studentët në lidhje me mënyrën e kryerjes së vetëvlerësimit dhe aplikimit për një vend pune (<https://ubt.edu.al/sq/2020/05/20/aplikojme-per-pune/>; e gjeni në faqen e internetit të universitetit). Manuali bazohet në përvojat më të mira evropiane. Studentët mund ta përdorin atë dhe të punojnë vetë ose të kërkojnë këshilla individuale. Projekti bashkëpunon me një kompani private rekrutimi (*Development Dynamics*), e cila ka krijuar platformën (*Expert Lane*) e konceptuar si një sportel i vetëm për shërbimet e karrierës. Projekti ka mbështetur zhvillimin e elementeve të ndryshëm të platformës. RisiAlbania bashkëpunon shumë mirë me mediat dhe ka zhvilluar aktivitete për t'i kthyer mediat masive në një ofrues të vazhdueshëm informacioni për çështjet e punësimit për të rinjtë. Projekti ka bashkëpunuar me disa forma të ndryshme të mediave për të hartuar, prodhuar dhe shpërndarë rregullisht informacionin në lidhje me tregun e punës në formate tërheqëse dhe me përmbajtje për të rinjtë.

'Aftësi për Punë S4J (<https://skillsforjobs.al/>; Faza I: 2016–2019 dhe Faza II: 2019–2023) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) që mbulon 10 institucione të arsimit dhe formimit profesional (AAP). Orientimi në karrierë filloi në vitin 2016 dhe është një shërbim i ofruar nga shkollat profesionale si një nga funksionet e njësisë së zhvillimit. Projekti mbështet nëntë shkolla profesionale dhe një qendër të formimit profesional. Pas miratimit të ligjit, njësia e zhvillimit u kthye në njësi operacionale. Janë pilotuar qasje nga më të ndryshmet (është përdorur qasja nga poshtë-lart). Bazuar në praktikën më të mira është vënë në dispozicion edhe një manual për orientimin në karrierë. Qasja e orientimit në karrierë e propozuar në këtë manual synon të shkojë përtej njohjes së thjeshtë të mundësive për karrierë, përzgjedhjes së karrierës apo testeve të vetëvlerësimit. Orientimi në këtë manual është konceptuar si një proces gjithëpërfshirës këshillimi, për t'u dhënë nxënësve mbështetjen dhe informacionin e duhur për të projektuar dhe, kudo dhe kur është e mundur, për të nisur karrierën e tyre dhe për të planifikuar të ardhmen.

Manuali ofron informacione, udhëzime, shembuj, praktika dhe burime që janë të rëndësishme për punën e përditshme të koordinatorëve të shërbimeve të orientimit dhe këshillimit në karrierë ose të personave të tjerë të interesuar në këtë fushë. Ai mund të përdoret si një udhëzues praktik për të adresuar probleme dhe çështje specifike ndërkohë që institucionet e AFP-së përpiqen të ofrojnë shërbime cilësore për orientimin dhe këshillimin e nxënësve në lidhje me karrierën.

Zgjedhja e karrierës është një hap shumë i rëndësishëm për të ardhmen e të rinjve që përfshin mbështetjen e prindërve, mësuesve dhe këshilluesve të karrierës. Për të mbështetur këtë proces, projekti 'Aftësi për Punë' ka hartuar profilet e kërkesave dhe përshkrimet e vendeve të punës për 20 profesione. Ky informacion (i quajtur 'buqeta e profesioneve') është vënë në dispozicion nëpër shkolla. Personi përgjegjës për njësinë e zhvillimit që mbulon çështjet e orientimit dhe këshillimit në karrierë e ndan atë me palët e interesit.

Kompanitë private të rekrutimit

Portali i punës DUAPUNE – vende pune dhe shërbime karriere *online*
(<https://www.duapune.com/>)

Kompania *DM Consulting Services* (<http://dm-consulting.biz/>) ofron shërbime të personalizuar për orientimin në karrierë. Për individët që kanë nevojë për këshillim në karrierë, ofrohet një shërbim i personalizuar me anë të kontaktimit të drejtpërdrejtë me personin e interesuar, në shumicën e rasteve për individë të nivelit të lartë (menaxherë të lartë). Gjithashtu, kompania ka edhe një blog arsimor (blog.duapune.com ose duapune.com/blog) në kuadrin e shërbimit të saj *Edu DP*. Ky është një blog i hapur për të gjithë personat e interesuar. Manuali 'Udhëzuesi juaj i Karrierës' (<https://www.duapune.com/career-guide>; botim i një kompanie) dhe ushtrimet shoqëruese është një dokument publik i krijuar për të ndihmuar ata persona që kërkojnë marrjen e shërbimit të këshillimit në lidhje me karrierën e tyre.

Expert Lane – Platforma e Karrierës (www.expertlane.al)

Kompania e shërbimeve të konsulencës dhe nënkontraktimit *Dynamics Partners* (<https://dynamicspartners.al/>), në bashkëpunim me *AIMS Albania* (<https://aims.al/>), ka krijuar *Expert Lane* - Platformën e Karrierës. Përmes kësaj platforme autentike të karrierës, *Expert Lane* krijon një shteg drejt mundësive për punëkërkuuesit e rinj. *Dynamics Partners* i ndihmon punëkërkuuesit e rinj në moshë për të zbuluar potencialin dhe për të përmirësuar aftësitë e tyre, ndërkohë që siguron individë fleksibël dhe tejet të trajnuar edhe për punëdhënësit.

Kapaciteti individual

Specialistët e shkollave: Projekte të ndryshme kanë investuar për mbështetjen dhe ngritjen e kapaciteteve të një grupi me specialistë shkollorë. Praktikën e zbatuar në shkollat apo në qendrat e mbështetura nga këto projekte duhet të përgjithësohen dhe të shtrihen në të gjitha shkollat e tjera.

KULTURA NË LIDHJE ME ORIENTIMIN PËR KARRIERËN

Specialistët mbështeten përmes projekteve të donatorëve dhe seancave të trajnimit, të cilat kontribuojnë në reputacionin e punës së tyre dhe forcojnë qëndrimin për vlerësimin e investimeve në fushën e orientimit për karrierën.

Bazuar në këto përvoja, nevojitet përgatitja e programeve të trajnimit për këta specialistë (zhvillimi i aftësive për menaxhimin e karrierës duhet të jetë pjesë e trajnimit).

Specialistët e AKPA-s: Për të promovuar zhvillimin e të rinjve, projekti 'Këshillimi për Punësim dhe Sipërmarrje' (C4EE, 2017-2020) përpaket të gjejë zgjidhje për problematika dhe kufizime të tilla si mungesa e aftësive profesionale dhe aftësive për jetën tek të rinjtë pjesëmarrës, mungesa e njohurive dhe orientimit në lidhje me mundësitë në tregun e punës dhe mungesa e qasjes dhe e shërbimeve të duhura në këtë kontekst në nivele të ndryshme. Kjo është arritur nëpërmjet trajnimit të mentorëve që zbatojnë ciklin e mentorimit (i cili është zhvilluar në bashkëpunim me *Hochschule Luzern*). Përveç kësaj, është forcuar edhe bashkëpunimi midis aktorëve të sektorit shtetëror dhe atij privat në fushën e punësimit. Sikli i mentorimit zbatohet nga 20 trajnerë/ mentorë në 12 shërbime rajonale të punësimit në Shqipëri (AKPA). Modeli i ciklit të mentorimit njihet nga AKPA si një shërbim për të rriturit e rinj në moshë dhe të pafavorizuar dhe përfshihet në ofertën e formimit profesional shtetëror.

Specialistët e universiteteve: AKAFPK (në kuadrin e projektit *Erasmus*) është duke zbatuar një projekt, një studim, i cili është në proces e sipër, në lidhje me *status quo*-në e shërbimit të orientimit në karrierë, duke u përqendruar në mënyrë të veçantë tek sistemi i AFP-së për të mbështetur njësitë e zhvillimit brenda shkollave dhe qendrave. Pas studimit, do të përcaktohet modeli i orientimit për karrierën dhe do të zhvillohen kapacitetet e nevojshme (qëllimi është futja në përdorim e qasjes sistematike në lidhje me ofrimin e mbështetjes). RisiAlbania ka bashkëpunuar me Fakultetin e Shkencave Sociale për të trajnuar këshillues të karrierës. Grupi i parë prej 20 këshilluesish të karrierës janë duke ndjekur një kurs tre-javor për të marrë certifikimin ndërkombëtar si lehtësues globalë për zhvillimin e karrierës. Trajnimi i mbështetur nga RisiAlbania është një mundësi e shkëlqyer për krijimin e rrjeteve. Ky është një hap i madh drejt përmirësimit të shërbimeve të karrierës në universitete dhe hedh bazat për krijimin e grupit të parë me ekspertë dhe lehtësues të shërbimeve të karrierës për tregun shqiptar, i cili është i domosdoshëm për punësimin cilësor të të rinjve. Grupi i ri prej 20 vetash sapo ka filluar rrugëtimin e tij. Ndërgjegjësimi në lidhje me rëndësinë e shërbimeve të orientimit në karrierë të nxënësve/ studentëve për integrimin në tregun e punës dhe për zhvillimin e tyre akademik dhe profesional është në rritje.

Punonjësit e AKPA-s (specialistë të zyrave të punësimit) në zyrat rajonale dhe lokale: Në gjysmën e dytë të vitit 2019, filloi zbatimi i procesit të profilizimit sipas ndryshimeve të bëra në sistemin e shërbimeve të punësimit. Ky proces filloi me trajnimin e 225 specialistëve të zyrave të punësimit, pasuar nga monitorimi dhe ofrimi i ndihmës për profilizimin e saktë të punëkërkuësve të papunë. Ndërkohë, është përdorur edhe modeli i planit individual të punësimit, i cili përmban të gjitha elementet që i ndihmojnë punëkërkuësit e papunë dhe këshilluesit e tyre për të ndjekur progresin drejt integritit (të punëkërkuësve) në tregun e punës.

SHTOJCA I: SHEMBUJ TË PRAKTIKËS SË MIRË

ORIENTIMI PËR KARRIERËN NË FUSHËN E PUNËSIMIT

Pjesë e ciklit të trajtimit të punëkërkuësve është edhe procesi i udhëzimit të tyre në lidhje me orientimin për karrierën. Ky proces adreson orientimin në karrierë të punëkërkuësve të regjistruar në zyrën e punësimit, një hap që ndërmerret para përfshirjes së tyre në një kurs kualifikimi profesional, në një program praktike profesionale ose program trajnimi në vendin e punës.

Paketa e orientimit për karrierën përfshin shërbimet e mëposhtme: i) shpjegimi i sistemit të Aftësive, Kompetencave, Kualifikimeve dhe Profesioneve Evropiane (ESCO) –ISCO dhe përputhja automatike, ii) testi 'Gjeni veten', iii) aftësitë e buta, iv) eksplorimi i botës së punës, dhe v) praktikatat afatshkurtra profesionale.

AKPA ka bashkëpunuar mirë me projektin *C4EE* për integrimin e suksesshëm të të rinjve të rritur në botën e punës. Qëllimi i projektit ishte integrimi i të rinjve të marginalizuar ose me prejardhje nga familje migrante në tregun e punës. Projekti filloi në vitin 2017. Në vitin 2019, në ciklin e këshillimit morën pjesë 568 të rinj nga të cilët 54% ishin gra. Nga viti 2017 deri në vitin 2019, cikli i këshillimit u ndoq nga 1,293 pjesëmarrës nga të cilët 49% ishin femra. Për të promovuar zhvillimin e të rinjve, projekti kërkon të adresojë kufizime të tilla si mungesa e aftësive profesionale të pjesëmarrësve të rinj në moshë, mungesa e njohurive dhe orientimit të tyre në lidhje me mundësitë në tregun e punës dhe mungesa e qasjes dhe shërbimeve të përshtatshme në këtë kontekst në nivele të ndryshme. Përfituesit janë nga komunitetet romë dhe egjiptiane ose me prejardhje nga familje migrantësh. Përmes praktikave profesionale në sektorë të ndryshëm, pjesëmarrësit mësojnë rreth aftësive të tyre individuale dhe se si mund t'i përmirësojnë ato. Me qëllim përfshirjen e punëkërkuësve të papunë në ciklin e këshillimit në lidhje me punësimin, janë trajnuar 18 trajnerë në 12 drejtori rajonale të punësimit.

Ofruesit e shërbimeve të orientimit për karrierën në zyrat e punësimit janë përgjegjës për përputhjen e punëkërkuësve të papunë me nevojat e biznesit, bazuar në aftësitë dhe përvojën e punëkërkuësve. Kjo sjell me vete nevojën për të individualizuar qasjen e këshillimit për punëkërkuësit dhe për të përshtatur ndërhyrjen dhe këshillimin për nevojat e tyre dhe të tregut. Plani individual i punësimit dhe qasja e strukturuar janë mjete shumë të rëndësishme pune në duart e këshilluesve. Plani individual i punësimit e bën orientimin në karrierë më të personalizuar dhe mbështet punëkërkuësit e papunë në nivelin e tyre aktual të punësimit.

PRAKTIKA E MIRË NË LIDHJE ME NDËRHYRJEN E DONATORËVE E FOKUSUAR TEK ORIENTIMI PËR KARRIERËN

RisiAlbania (<https://www.risialbania.al/>), projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) synon të kontribuojë në rritjen e punësimit të grave dhe burrave të rinj në moshë në Shqipëri. Në fokus të projektit është puna për mbështetjen e grave dhe burrave të rinj në moshë për të marrë vendime të informuara në lidhje me arsimimin dhe mundësitë e tyre për punësim përmes shërbimit efektiv të orientimit për karrierën. Pesë janë fushat e ndërhyrjes së projektit RisiAlbania në lidhje me orientimin në karrierë.

1. Zhvillimi i një shërbimi publik (me bashkinë e Tiranës) përmes qendrës së hapur për zhvillimin e karrierës

Bashkia e Tiranës, në bashkëpunim me zyrën vendore arsimore, do të ngrenë një qendër karriere në nivel qyteti. Kjo qendër do të jetë e hapur për të gjithë, përfshirë nxënësit/ studentët e rinj në moshë si dhe të rriturit. Këshilluesit e karrierës së qendrës do të vizitojnë shkollat dhe do të komunikojnë dhe shkëmbejnë informacione me këshilluesit e karrierës nëpër shkolla. Së bashku ata do të ndërmarrin aktivitete të përbashkëta, kryesisht të lidhura me këshillimin në karrierë.

Qendra e karrierës do të fillojë me një shërbim bazë dhe më pas do të punohet për plotësimin e shërbimeve. Deri më tani, është zgjedhur personeli. Qëllimi është institucionalizimi i këtij shërbimi. Organigrama e bashkisë tregon se sektori i këshillimit në karrierë është krijuar pranë drejtorisë për nxitjen e punësimit (e cila adreson punësimin e të rinjve dhe grupeve të marginalizuara). Prandaj, orientimi për karrierën do të jetë një funksion i përhershëm i saj. Midis bashkisë dhe Ministrisë së

Arsimit, Sportit dhe Rinisë është nënshkruar një marrëveshje. Ndërkohë, projekti ka hartuar edhe një modul trajnimi për këshilluesit e karrierës. Modulet për klasat 3, 4, 5, 7, 8 dhe 9 janë përfunduar dhe do të lëvrohen nga mësuesit kujdestarë në bashkëpunim me psikologët e shkollës.

Projekti po punon për të mundësuar ofrimin e shërbimeve të karrierës nëpër shkolla përmes zyrës bashkiake, dhe për të krijuar mundësinë e ofrit të një shërbimi të tillë në internet. RisiAlbania është duke zhvilluar një portal për karrierën. Informacioni që do të gjenerohet përshkruan profesionet (deri në fund të nëntorit, përshkrimet e rreth 60 profesioneve do të jenë gati). Ndërkohë, do të vihen në dispozicion disa ilustrime të profesioneve me anën e videos si dhe informacion në lidhje me mundësitë për arsimim dhe punësim. Portali përmban një bazë të dhënash për të gjithë ofruesit e AFP-së (publik dhe privat) në Tiranë. Portali do të gjenerojë ofertën e shkollave profesionale, qendrave të formimit profesional dhe universiteteve. Për secilin profesion do të përdoren linqet për tu lidhur me portalet e punësimit ose kompanitë e rekrutimit.

Tre janë testet e interesit (të zhvilluara nga Fakulteti i Shkencave Sociale) që do të vihen në dispozicion për këtë qëllim. Në qendrën e karrierës, pala e interesuar do të marrë informacion bazuar në interesin personal pas kryerjes së testeve të interesit. Portali do të jetë gati në fund të muajit nëntor. Ky portal është më shumë se kaq, pasi do të funksionojë edhe si rrjet i brendshëm komunikimi (*intranet*) për stafin e zyrave bashkiake. Ai mund të konsiderohet si mjet menaxhimi.

2. Shërbimi i orientimit për karrierën në nivel universitar

Projekti RisiAlbania ka bashkëpunuar me katër universitete. Fokusi i punës ishte trajnimi (trajnimi tre-javor) i këshilluesve të karrierës në këto universitete bazuar në sistemin ndërkombëtar të karrierës (lehtësues globalë për zhvillimin e karrierës). Këshilluesit u trajnuan dhe u mësuan në lidhje me mënyrën se si duhet të punojnë me studentët (përgatitja e jetëshkrimit, përgatitja e letrës së motivimit, përgatitja për një intervistë dhe kryerja e vetëvlerësimit).

Njëmbëdhjetë universitete janë të përfshira në projektin e BE-së të quajtur *GRADUA* (Avancimi i të Diplomuarve dhe Zhvillimi i Kapaciteteve Universitare në Shqipëri) në kuadrin e projektit Erasmus (<https://www.graduaproject.com/#>) dhe në bashkëpunim me Universitetin e Bolonjës. Qëllimi i projektit është zhvillimi i një platforme (*AlmaLaurea*) për studentët, e cila do të akomodohet nga Rrjeti Akademik Shqiptar dhe mund të aksesohet përmes faqes së internetit të projektit *GRADUA* në seksionin Publikime & Artikuj. Platforma do t'i sjellë universitetet më afër tregut të punës. *Gradua* është një platformë me burim të hapur dhe RisiAlbania synon të marrë pjesë në hartimin e modulit në lidhje me orientimin në karrierë. Shërbimet e karrierës u zhvendosën në internet gjatë pandemisë ku u zhvilluan edhe seancat e trajnimit.

Projekti ka përgatitur një manual për studentët në lidhje me mënyrën e kryerjes së vetëvlerësimit dhe të aplikimit për punë (<https://ubt.edu.al/sq/2020/05/20/aplikojme-per-pune/> në dispozicion në faqen e internetit të universitetit), duke u bazuar në përvojat më të mira evropiane. Ky manual mund të aksesohet nga studentët, të cilët mund të punojnë vetë ose të kërkojnë këshilla individuale. Sigurisht, kjo nuk do të jetë e lehtë pasi raporti këshillues karriere - student është joproporcional (p.sh. Universiteti i Durrësit ka 17,000 studentë dhe vetëm 4 këshillues karriere).

Zhvillimi i shërbimeve të karrierës dhe ofrimi profesional i këtyre shërbimeve për të mundësuar vendimmarrje të mirëinformuar është pikërisht fokusi i punës së bërë me Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës. Studiuesit në këtë institucion kanë përshtatur për Shqipërinë tre instrumente ndërkombëtare në lidhje me zhvillimin e shërbimeve të karrierës. Ato janë *Personal Globe Inventory* (PGI), *Career Decision-Making Difficulties Questionnaire* (CDDQ) dhe *Oriented Demand Analysis* (ADOR). Së shpejti do të botohet edhe një manual, i cili do të vihet në dispozicion të këshilluesve dhe specialistëve të shërbimit të karrierës.

3. Zhvillimi i shërbimit me pagesë për këshillimin në karrierë për individët privatë

Projekti është duke bashkëpunuar me kompaninë private të rekrutimit (*Development Dynamics*) e cila ka krijuar platformën *Expert Lane*. Kjo platformë është konceptuar si një sportel i vetëm për marrjen e shërbimeve (*one-stop shop*). Së pari, bëhet vlerësimi i individit. Pastaj, kandidatit i jepen këshilla të cilat duhet t'i zbatojë. Bazuar në vlerësimin e kandidatit, atij/ asaj i ofrohen kurset e nevojshme (për zhvillimin e aftësive për punësim). Pas kurseve, procedura fillon me punëdhënësin (procedura e

përputhjes/ ndërmjetësimit). Prandaj, përveç shërbimeve të këshillimit, kompania kryen edhe shërbime të lidhura me punësimin. Projekti RisiAlbania ka mbështetur zhvillimin e elementeve të ndryshëm të kësaj platforme.

4. Zhvillimi i kërkimit shkencor në fushën e këshillimit të karrierës

RisiAlbania ka bashkëpunuar me Fakultetin e Shkencave Sociale për të trajnuar këshilluesit e karrierës dhe për të kryer kërkime shkencore. Ky fakultet është i vetmi institucion i arsimit të lartë që ofron një program të nivelit master në fushën e këshillimit (Këshillues i Karrierës). Fakulteti i Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës dhe në Universitetin e Lozanës ofrojnë bashkarisht diplomën pesë-vjeçare të nivelit master. Partneriteti midis dy universiteteve bazohet në agjendën për kërkimin bashkëpunues dhe aktivitetet për rishikimin e kurrikulave.

Një nga qëllimet ka të bëjë me standardizimin e tre testeve ndërkombëtare të interesit. Këto teste do të përdoren edhe nga bashkia e Tiranës. Testet shoqërohen edhe nga manualët përkatës dhe së shpejti do të përdoren edhe nga këshilluesit në qendrën e karrierës (e cila pritet të fillojë punën në fund të muajit nëntor) në formatin *online*. Sipas një marrëveshjeje të lidhur midis bashkisë, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Fakultetit të Shkencave Sociale studentëve të nivelit master iu ofrohet mundësia për të zhvilluar praktikën e tyre profesionale në këtë qendër karriere.

5. Paraqitja e materialeve tërheqëse për orientimin në karrierë përmes mediave

RisiAlbania njeh rolin potencial dinamik dhe katalitik të mediave të shkruara dhe mjeteve masive të komunikimit në internet, të transmetimeve televizive dhe radiofonike, pasi ato mund të arrijnë dhe të ndikojnë tek një numër i madh njerëzish. Gjatë fazës I (2013–2017), qëllimi i projektit ishte që mjetet e komunikimit masiv të ktheheshin në një ofrues të vazhdueshëm të informacionit në lidhje me çështjet e punësimit për të rinjtë. Projekti krijoi partneritete me forma të ndryshme të mediave për të hartuar, prodhuar dhe shpërndarë rregullisht informacionin në lidhje me tregun e punës me formate dhe materiale tërheqëse për të rinjtë. Mbështetja e projektit RisiAlbania u përqendrua në mënyrë të veçantë tek krijimi i stimuljeve komerciale për mediat me qëllim mbulimin e çështjeve të punësimit në mënyrë sa më tërheqëse. Edhe gjatë kësaj faze, puna me mediat rezultoi në hartimin, lançimin dhe realizimin, në Fakultetin e Gazetarisë dhe Komunikimit, të një moduli për raportimin mbi tregun e punës. Ky modul fakultativ, i cili vazhdon të ofrohet, u krijua me synimin për t'u demonstruar gazetarëve të ardhshëm rëndësinë e raportimit për tregun e punës dhe për t'i orientuar ata në lidhje me mënyrat që duhet të përdorin për ta arritur një gjë të tillë.

Mbështetja gjatë fazës II (2017–2021): RisiAlbania e shfrytëzoi përvojën e suksesshme të përfutur nga puna me median në fazën e parë. Mbështetja e ofruar për mjetet masive të komunikimit gjatë fazës I të projektit dhe qëndrueshmëria dhe përshkallëzimi i demonstruar sa i takon shpërndarjes së informacionit për tregun e punës, hodhi një themel të fortë për përdorimin e një qasjeje të ngjashme në lidhje me temat për orientimin në karrierë për të rinjtë dhe prindërit e tyre gjatë fazës II. Aktualisht, produktet mediatike që janë aktive ose që pritet të fillojnë së shpejti sezonin e tyre të ardhshëm janë pesë. Ata tani realizohen pa mbështetjen ose me shumë pak mbështetje nga RisiAlbania. Këto produkte mediatike përfshijnë: 'Rruga drejt suksesit' nga Club FM Radio; 'Drejt Punës' nga gazeta Shqiptarja.com dhe platforma online; 'Më i miri në vend' shpërndarë në RTSH; 'Puna që dua' e shpërndarë në InTV, RTSH2; and 'Think Big' by New Media Communications (prodhuar mediatik), e shpërndarë në internet.

Përmbledhje e shërbimeve dhe rezultateve

Shërbimet e orientimit për karrierën	Rezultatet
Ofrimi i orientimit për karrierën si shërbim i komunitetit	Modeli për ofrimin e shërbimeve për orientimin në karrierë i zhvilluar në nivel bashkiak
Forcimi i orientimit për karrierën si shërbim universitar	Mbështetja strategjike e hartuar në nivel universitar
Program mësimor bashkëkohor për këshilluesit	Fakulteti i Shkencave Sociale bashkëpunon me

e karrierës

Universitetin e Lozanës për përgatitjen e këshilluesve të karrierës

Paraqitja e materialeve tërheqëse për orientimin në karrierë përmes mediave

Pesë kanale mediatike fillojnë të shfaqin materiale në lidhje me orientimin në karrierë

SHTOJCA III: LISTA E REFERENCAVE

Programi i Reformës Ekonomike në Shqipëri 2020-2022:

<https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/Economic-Reform-Programme-2019-2021.pdf>

Raporti vjetor për zbatimin e ndihmës IPA II: <http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2020/05/IPA-II-Annual-Implementation-Report-2019-ALBANIA.pdf>

RisiAlbania: Rishikimi i gjendjes aktuale të Orientimit dhe Këshillimit për Karrierën në Shqipëri:

<http://risialbania.al/index/wp-content/uploads/2017/03/Review-of-current-state-of-Career-Guidance-and-counseling-in-Albania.pdf>

Kuvendi i Shqipërisë: Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022

Kuvendi i Shqipërisë: Ligji "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë"

Kuvendi i Shqipërisë: Ligji "Për Nxitjen e Punësimit"

Kuvendi i Shqipërisë: Ligji "Për Arsimin e Lartë"

Kuvendi i Shqipërisë: Ligji "Për Arsimin Parauniversitar"

MFE: Udhëzim "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional"